

## Takim me nxënës nga shkolla profesionale “Faik Konica” Ferizaj, Kosovë në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale, Elbasan

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në Universitetin e Elbasanit, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale” Elbasan, organizoi një takim informues me një grup nxënësish nga shkolla profesionale “Faik Konica” Ferizaj, Kosovë.

Takimi u bë i mundur në sajë të binjakëzimit mes dy shkollave profesionale dhe fillimisht nxënësit u pritën në Korpusin kryesor të universitetit, ku u informuan mbi paketën akademike, infrastrukturën, mbështetjen e stafit akademik dhe ndihmë akademike, si edhe mundësitë e shumta, për zgjedhjen e rrugëtimit të tyre akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Më pas nxënësit, zhvilluan një guidë në ambientet e fakulteteve, drejtorive dhe bibliotekën e Universitetit të Elbasanit.







